



Datë: 5 Dhjetor 2022

TERMA REFERENCE

SHËRBIMI I KËRKUAR: EKSPERTIZË LIGJORE

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbrojtjen e drejtave të tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është themeluar më 8 Qershor 2022 me iniciativën e tre grave aktiviste të shoqërisë civile të cilat, prej më tepër se 10 vitesh, kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë më datë 28/06/2022 me vendimin nr. 1738. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar gjithashtu pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

Misioni i Qendrës është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Qendra për Drejtësi Gjinore, më 1 Dhjetor 2022, ka filluar implementimin e projektit "Make women safe!", mbështetur financiarisht nga Mediterranean Women's Fund.

Në kuadër të projektit, kërkohet konsulencë e jashme nga një ekspert ligjor për realizimin e:

- 6 trajnimeve me specialistët e zonave (SPZ) në Komisariatet e Policisë: Tiranë, Elbasan, Durrës, Lushnjë, Fier, Vlorë. Tematika kryesore e trajnimeve do të jetë "Policia e shtetit për një përgjigje efektive ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje";
- Sesioneve të mentorimit për specialistët e zonave (SPZ) në Komisaratin e Policisë, Tiranë për identifikimin e faktorëve të riskut dhe menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

3. PERIUDHA E SHËRBIMIT TË KËRKUAR

Shërbimi të ofrohet gjatë periudhës 23 Dhjetor 2022 – 30 Prill 2023.

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Zhvillimi i moduleve të trajnimeve sipas standardeve dhe cilësisë të kërkuar nga Qendra për Drejtësi Gjinore;

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Medar Shtylla", Nd. 26/5, Ap. 77, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; e-mail: office@gjalbania.org; Tel: +355692667531



- Planifikimi dhe realizimi i 6 trajnimeve në Komisaritet e Policisë: Tiranë, Elbasan, Durrës, Lushnjë, Fier, Vlorë;
- Realizimi i sesioneve të mentorimit me Specialistët e Zonave në Komisaritet e Policisë, Tiranë (mentorimi për Komisaritate në zona të tjera nuk është i përjashtuar);
- Raportim periodik tek Qendra për Drejtësi Gjinore mbi ecurinë e punës dhe sfidave/vështirësive që mund të ndikojnë në mbarëvajtjen e aktiviteteve/shërbimeve;
- Hartimi i një raporti të shkruar në përfundim të trajnimeve dhe sesioneve të mentorimit ku të jenë të evidentuara sfida dhe gjetje nga kontaktet direkte me specialistët e zonave në Komisaritet e Policisë të përfshira në projekt;

5. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare në drejtësi;
- Master shkencor ose profesional në drejtësi;
- Të paktën 3 vite eksperiencë pune në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore (preferohet avokat/e i/e cili/a të ketë përfaqësuar në institucionet e sistemit të drejtësisë gra dhe vajza viktimë të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore);
- Të zotërojnë njohuri shumë të mira të çështjeve gjinore dhe ndjeshmëri gjinore;
- Të zotërojnë aftësi shumë të mira të folurit në publik;
- Të zotërojnë aftësi shumë të mira komunikuese;
- Të jetë bashkëpunues/e, me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

6. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Letër motivimi;
- CV;
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar.

Adresë elektronike: office@gjalbania.org; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Medar Shtylla", Nd. 26/5, Ap. 77, Tiranë, Shqipëri.

7. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 15/12/2022, ora 17:00

Njoftimi i aplikanëve: 20/12/2022